

PROJEKT ZBATIMI

OBJEKTI: “RIKONSTRUKSION ME RIVESHJE TË KOLEKTORËVE NË ITUN, INSTALIM MAKINERIE NË STACIONET EKZISTUESE DHE PASTRIM KOLEKTORI NË ZONËN E QYTETIT, BASHKIA DURRËS”

- RELACIONI TEKNIK
- PREVENTIVI I OBJEKTIT
- ANALIZAT TEKNIKE TE ÇMIMEVE
- SPECIFIKIMET TEKNIKE

RELACIONI TEKNIK

OBJEKTI: “RIKONSTRUKSION ME RIVESHJE TË KOLEKTORËVE NË ITUN, INSTALIM MAKINERIE NË STACIONET EKZISTUESE DHE PASTRIM KOLEKTORI NË ZONËN E QYTETIT, BASHKIA DURRËS”

KORRIK 2020

RAPORTI TEKNIK

OBJEKTI : “ Rikonstruksion me riveshje të kolektorëve në ITUN, instalim makinerie në Stacionet ekzistuese dhe pastrim kolektori në zonën e qytetit, Bashkia Durrës”

I. PERSHKRIMI I PROJEKTIT

1. Të Përgjithshme

Hartimi i projektit me objekt:“Rikonstruksion me riveshje të kolektorëve në ITUN, instalim makinerie në Stacionet ekzistuese dhe pastrim kolektori në zonën e qytetit, Bashkia Durrës” është bërë nga stafi i Departamentit Teknik sh.a Durrës, bazuar në emergjencen në ndërhyrje në riparimin e kolektorit të ITUN, fenomenin e përmytjes në zonën e stadiumit nga ujërat sipërfaqësor në periudhën e rreshjeve, si dhe në bllokimin e pompave të stacioneve të pompimit të kanalizimeve në zonën e plazhit nga Përroi Agait deri ne Plepa.

2. Gjendja ekzistuese e rrjetit të kanalizimeve të zonës

Zona ku do të kryhet investimi ndodhet në zonën e Impiantit të Trajtimit të Ujerave të Ndotura Shënvllash, në Lagjen nr.18 të qytetit të Durresit Rr.”Hysen Kertusha”, Rr.”Kristo Sotiri”dhe Rr.”Mbreti Pirro”, si dhe në stacionet e pompimit (NPS1/3, EPS1,) në zonën e Shkëmbit të Kavajës.

- Kolektori Ø600 mm çeliku që dërgon ujin nga paratrajtimi në vaskat e oksidimit është gripuar dhe ka shkaktuar prishje të skarpatës. Ndërhyrja në të është emergjente, sepse mund të agravoj dëmtimin deri në mosfukcionim të paratrajtimit dhe kjo sjellë mosfukcionim të ITUN.
Kolektori Ø800 mm që dërgon ujërat e ndotura nga stacioni i pompimit në paratrajtim, ka pësuar dëmtim dhe zëvendësimi i tij duhet bërë me tubacion polietileni. Gjithashtu dhe kolektori Ø350 mm në trashuesit e llumit ka pësuar gripim dhe zëvendësimi i tyre me tubcion polietileni është i nevojshëm dhe urgjent, sepse nuk funksionon impianti.
- Kolektori i ujërave të shiut që fillon nga drejtorja e policisë dhe përfundon në dy kolektorët Ø2200 mm në Rr.“Vllazërimi” dhe kolektori që fillon në kryqëzimi spitalit dhe përfundon në dy kolektorët Ø2200 mm në Rr. “ Vllazërimi”, nuk është pastruar prej vitesh dhe kjo gjendje e tyra ka shkaktuar probleme gjatë periudhës së reshjeve të shiut. Ndërhyrja në këto kolektorë duhet bërë me anë të makinerive të specializuara për pastrimin e kolektorëve.
- Në stacionet e pompimit që janë përgjatë vijës bregdetare Përroi Agait-Plepa dhe pranë detit, kemi patur probleme të vazhdueshme në bllokimin e pompave, të cilat janë shkaktuar si rezultat i depozitimit të materialeve të trasha që vijnë nga rrjeti i kanalizimeve. Kjo situatë e përsëritur dhe ankesat e vazhdueshme të resorteve dhe hoteleve të zonës ka bërë nevojshme ndërhyrjet në stacionet e pompave duke instaluar disa makineri copëtuese për materialet e ngurta të depozituara në puse.



Foto nga stacionet e pompimit



Foto nga ITUND



Foto nga koletori i ujërave të shiut

II. OBJEKTIVI.

Objektivi kryesor është hartimi i projektit të zbatimit për rehabilitim të kolektorëve në ITUND-in Shënvllash, pastrimin e kolektorëve në Lagjen nr.18 në qytetin e Durrësit, Rr."Hysen Kërtusha", në Rr."Kristo Sotiri" dhe Rr."Glaukia", si dhe instalimin e paisjeve copëtuese në SP (NPS1/3, EPS1) nga Përroi i Agait deri në Plepa.

III. QËLLIMI I PROJEKTIT.

Projekti ka si qëllim të zgjidhë gjendejn emergjente që është krijuar në impiant nga amortizimi i rrjetit, të zgjidhë problemin e përmytjeve në zonën e stadiumit gjatë rreshjeve të shiut si dhe të eliminoj problemin e bllokimit të pompave në vijën bregdetare nga Përroi i Agait deri në Plepa . Ndërhyrja parashikon rehabilitimin e kanalit ekzistues nga puseta Nr.1 deri në puseta Nr.41 në Rr."Hysen Kërtusha" dhe nga puseta Nr.1 deri në pusetën Nr.25, Rr."Kristo Sotiri" dhe Rr."Glaukia".

Ndërhyrja konsiston në riaftësimin e rrjetit të kanalit të ujërave të shiut sipas gjurmës së projektuar duke realizuar: pastrimin e kolektorëve, riparimin e veshjeve të dëmtuara si dhe ndërtim pusetash kontrolli të reja për mirëmbajtjen dhe funksionimin e kolektorit. Furnizimi me ujë i automjeteve teknologjike do kryhet nga ana e ujësjellësit nëpërmjet hidranteve apo autoboteve të shoqërisë UKD.

Projekti përfshin:

- Pastrimin me makineri të kolektorit me diametër Ø800 mm b/a me gjatësi L=86ml bllokuar në 85% të kapacitetit të tij, i cili shtrihet përgjatë aksit të rrugës" Hysen Kërtusha"nga piketa Pk1 ÷ Pk4.
- Pastrimin me makineri të kolektorit me diametër Ø1000 mm b/a me gjatësi L=577ml bllokuar në 80% të kapacitetit të tij, i cili shtrihet përgjatë aksit të rrugës" Hysen Kërtusha"nga piketa Pk4 ÷ Pk31.

- Pastrimin me makineri të kolektorit me diametër Ø1200 mm b/a me gjatësi L=430ml bllokuar në 80% të kapacitetit të tij, i cili shtrihet përgjatë aksit të rrugës” Hysen Kërtusha”nga piketa Pk31 ÷ Pk41.
- Pastrimin me makineri të kolektorit me diametër Ø1200 mm b/a me gjatësi L=170ml bllokuar në 35% të kapacitetit të tij, i cili shtrihet përgjatë aksit të rrugës ”Kristo Sotiri” nga piketa Pk1 ÷ Pk9.
- Pastrimin me makineri të kolektorit me diametër Ø1500 mm b/a me gjatësi L=327ml bllokuar në 20% të kapacitetit të tij, i cili shtrihet përgjatë aksit të rrugës ”Kristo Sotiri” nga piketa Pk9 ÷ Pk23.
- Pastrimin me makineri të kolektorit me diametër Ø1500 mm b/a me gjatësi L=280ml bllokuar në 75% të kapacitetit të tij, i cili shtrihet përgjatë aksit të rrugës” Kristo Sotiri”nga piketa Pk23 ÷ Pk34.
- Pastrimin me makineri të kolektorit me diametër Ø1200 mm b/a me gjatësi L=335ml bllokuar në 80% të kapacitetit të tij, i cili shtrihet përgjatë aksit të rrugës” Glaukia”nga piketa Pk34 ÷ Pk46.
- Transport llumi me automjet pranë Impianti të Trajtimit të Ujërave të Ndotura Durrës.
- Ndërtim i pusetave të kontrollit përgjatë kolektorit.

Ndërhyrja në stacionet e pompimit konsiston në vendosjen e paisjes grirëse në SP (NPS1/3, EPS1) nga Përroi i Agait deri në Plepa.

Projekti përfshin:

- Instalimin e paisjeve grirëse në pusin e stacioneve të pompimit me të dhënat e stacionit si më poshtë:

Emertimi	Trashësia e thikave (mm)	Fuqia rrotuluese (kë)	Shpejtesia e rrotullimit (min-1)	Prurja (m3/h)	Gjeresia e grirëses
EPS1	8/32	4	35-40	700-1000	500 x 520
NPS1/2	8/32	4	35-40	520-1000	500 x 520

Emertimi	Numri i pompave	Kapaciteti [m3/h]	Lartësia [m]	Fuqia e stacionit [kë]	Tubi ne hyrje
EPS1	3(2+1)	669.6	5.07	14	OD400mm
NPS1/3	3(2+1)	511	8	18.5	OD560mm

Ndërhyrja në ITUND konsiston në riparimet e kolektorëve kryesor të cilët janë gripuar dhe kanë dëmtime do kryhen punimet si më poshtë:

Projekti përfshin:

- Riveshje të katër kolektoreve Ø600 mm çeliku nga vaska e paratrajtimit te vaskat e oksidimit.
- Pastrim i katër vaskave të oksidimit .
- Instalim i kolektorit Ø800 mm polietilen në dalje të stacionit të pompimit.
- Riparim me zëvendësim të kolektorit Ø350 mm çeliku me tubacion polietileni dhe zëvendësim i saraçineskave.
- Pastrim të vaskave të llumit me makineri.

IV. VOLUMET E PUNIMEVE.

Volumet e punimeve janë nxjerrë nga sipas vizatimeve .
Volume kryesore të punimeve janë:

V. KONKLUSIONE.

Në përfundim të projektit për zonën në studim për rehabilitim e stacioneve të pompimit në zonën Përroi Agait - Plepa , ITUN Shënavlash dhe kolektorin e ujërave të shiut pranë zonës së stadiumit Durrës, konkludojmë si më poshtë:

Rrejtja e kanalizimeve do mirëfunksionojë dhe do të lehtësojë punën për shoqërinë tone, si dhe do të rrisë efikasitetin në stacionet e pompimit.

Ndërhyrja në kanal ekzistues nga puseta Nr.1 deri në puseta Nr.41 në Rr."Hysen Kërtusha" dhe nga puseta Nr.1 deri në pusetën Nr.34, Rr."Kristo Sotiri" dhe nga puseta Nr.34 deri në pusetën Nr.46, Rr."Glaukia", do të rrisë përcjellshmërinë gjatë periudhës së shirave dhe minimizoj përmbytjet në këtë zonë.

Rikonstruksioni i kolektorëve në Impiantin e Trajtimit të Ujërave të Ndotura Shënavlash do të sjellë jetëgjatësi të impiantit dhe do të shmang mosfunksionimin e tij.

Instalimi i paisjeve grirëse në stacionet e pompimit nga Përroi Agait – Plepa do të shmangi djegjen e pompave, si dhe impaktin negativ që kanë shkaktuar në zonën e plazhit mosfunksionimi i këtyre stacioneve.

Preventivat e zbatimit janë vlerësuar sipas VKM. Nr.629 date 15.07.2015.

Në preventiv është përfshirë Fondi rezervë 5% dhe 20% T.V.SH

Analizat e çmimeve përpiluar sipas normativave të tregut.

Projektues

Ing. Hidro.Gerald Dautaj
Ing. Hidro. Lorenc Facja
Ing. Hidro. Daniela Shero
Ing. Hidro.Bledar Metalla
Ing. Hidro. Sedi Caushi
Ing. Ndërtimi.Artor Kocilja

ANALIZA TEKNIKE E ÇMIMEVE

OBJEKTI: “RIKONSTRUKSION ME RIVESHJE TË KOLEKTORËVE NË ITUN, INSTALIM MAKINERIE NË STACIONET EKZISTUESE DHE PASTRIM KOLEKTORI NË ZONËN E QYTETIT, BASHKIA DURRËS”

PREVENTIVI

OBJEKTI: “RIKONSTRUKSION ME RIVESHJE TË KOLEKTORËVE NË ITUN, INSTALIM MAKINERIE NË STACIONET EKZISTUESE DHE PASTRIM KOLEKTORI NË ZONËN E QYTETIT, BASHKIA DURRËS”